

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Jelena Krivokapiç, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve II., N., I2, K., M1., M2., B. dhe S. G., të gjithë nga fshati ... ,Komuna e ..., të cilët me autorizim i përfaqëson E. A. avokat nga ..., kundër të paditurës K, e S, “S, ” me seli në Prishtinë të cilën L. B., për shkak të shpërblimit të dëmit, nga baza e auto-përgjegjësisë duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditësve, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1225/2014 datë 15.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.02.2019, mori këtë:

A k t g j y k i m

- I. APROVOHET pjesërisht revizioni i paditësve, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1225/2014 datë 15.11.2018 dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega Lipjan C.nr.264/2012 datë 03.02.2014, NDRYSHOHEN sa i përket dëmit jo material, ashtu që e paditura KS “S. “ me seli në Prishtinë detyrohet që paditësve N. G.(nëna) dhe II. G. (baba) shumë prej 9.000,00 €,secilit veç e veç , paditësve I.2, G. (v.),K. G. (motrës), M.1 G. (motrës) , M2 G. (motrës) , B. G. (motrës)dhe S. G., (motër) shumë nga 5.000,00 €,secilit veç e veç, të gjitha me kamatë vjetore në lartësi prej 8%, duke filluar nga data 03.02.2014 ,nga dita kur është marr aktgjykimi i shkallë së parë gjerë në pagesën definitive.

- III . Në pjesën tjetër revizioni i të paditurës refuzohet si i pabazuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.264/2012 datë 03.02.2014, nën pikën I. të dispozitivit aprovet kërkesëpadia e paditësve si e bazuar dhe detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë që në emër të shpërblimit të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore të pësuar me rastin e vdekjes së birit, vëllait të tyre A. G., të shkaktuara në aksidentin e komunikacionit të datës 10.06.2012 paditësve t'u caktohet si në vijim: nënës N. G. shumë prej 11.500,00€, babait I. G. shumë prej 11.500,00 €; paditësit I. G. (vëllau), paditëseve: K., M., M., B. dhe S. G. (motra) secilit-es veç e veç shumë prej 8.000,00€.

Në emër të dëmit material e nga baza e përcaktuar në pikën I. të dispozitivit t'iu paguajë shumën e përgjithshme prej 13.870,60 €, dhe atë për shpenzimet e varrimit shumën prej 2.731 €, për ngritjen e lapidarit shumën prej 2.050 € dhe për shkak të humbjes së ushqyesit të vetëm shumën prej 9.089,60€, të gjitha këto me kamatë prej 8% duke filluar prej paraqitjes së padisë dt. 23.12.2012 deri në pagesën definitive.

Nën pikën II. të dispozitivit është detyruar e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore paditësve t'ua paguaj shumën prej 2.278.80€, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nënë kërcnimit e përmbarimit me dhunë.

Nën pikën III. të dispozitivit refuzohet , pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumën e gjykuar dhe atë që ka të bëjë : për kompensimin e dëmit jo material, dhimbjet shpirtërore dhe për shkak të humbjes tragjike të vëllait, për paditësit I., K., M., M., B. dhe S. G., për secilën veç e veç mbi shumën prej 8.000,00-10.000,00€ si dhe për kamatën mbi lartësinë e aprovuar prej 8-12% si e pa bazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1225/2014 datë 15.11.2018, nën pikën I. të dispozitivit ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.264/2012 i dt. 3.02.2014, për paditësit dhe për pjesët si në vijim:

“ Paditësit I. G. dhe paditëses N. G., si prindër në emër të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për shkak të vdekjes së djalit të tyre tani të ndjerë A. G. iu pranohet shuma e kompensimit nga 7.000,00€, secilit veç e veç, bashkë me dëmin material për shpenzimet e varrimit në shumë prej 1.200,00€ dhe për ngritje të lapidarit në shumë prej 1.500,00€, ndërsa paditësit I. G., vëllai i të ndjerit dhe paditësve K., M.,B. dhe S. G., (motra) të ndjerit, ju pranohet nga 4.000,00€, secilit veç e veç, të gjitha këto me kamatë vonesë ligjore të cilat i paguajnë bankat që operojnë në Kosovë, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 03.02.2014(data e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë), e deri në pagesën definitive , në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nënë kanosjen e përmbarimit me dhunë.

Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve përtej shumave të gjykuara , të ndryshuara si në paragrafin I të dispozitivit të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë. Në pikën II të dispozitivit është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.254/2012 datë 03.02.2014 në pjesën që i referohet shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Në pikën III, priset aktgjykimi në fjalë, në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit jo material, për dhimbjet shpirtërore të paditëses M. G. dhe në pjesën që i referohet rentës së kapitalazuar për të gjithë paditësit, ashtu që në këto pjesë i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim”.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë në afat ligjorë kanë paraqitur revizion paditësit përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim E. A. av., nga Prishtina, për shkak të

aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i atakuar në pikën I pjesën refuzuese përkitazi me kamatën ligjore si dhe pikën II të dispozitivit që ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve gjyqësore të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësve bashkërisht me kamatën ligjore si dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore për përpilimin e ankesës në shumë prej 457.00€ dhe përpilimit të revizionit në shumë prej 697,00€ të aprovohet si e bazuar, ose aktgjykimi i goditur në këtë pjesë të dispozitivit të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në aksidentin e komunikacionit me datën 10.06.2012, rreth orës 11:00 në rrugën Janjevë-Lipjan, gjegjësisht në fshatin D., është shkaktuar aksidenti i komunikacionit rrugor nga vetura e markës “VW Golf 1H” me targa të regjistrimit ..., të cilën e drejtonte D. M. nga fshati S. Komuna G. dhe veturës së markës “VW Golf 19E” me targa të regjistrimit ..., të cilën ditën kritike e drejtonte A. G. nga ... ,Nga kjo goditje përpos dëmeve materiale të shkaktuara në vetura shkaktohen edhe lëndime vdekjeprurës për shoferin e veturës “B” tani i ndjer A. G., djali i paditësit II. G. (babait) dhe (nënës)N. G., vëllaut I2. G., motrave K., M1., M2, B., dhe S., G..Paditësit për shkak vdekjes së djalit të tyre gjegjësisht vëllait kanë pësuar dëm material dhe jo material. E paditura sipas kërkesës së paditësve ka afruar paditësve në emër të dëmit material dhe jo material shumë e përgjithshme prej 11.000.00€. Paditësit për shkak të vdekjes së birit, dhe vëllait, kanë pësuar dhimbje shpirtërore si dëm jo material dhe shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores .

Gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve duke obliguar të paditurën që të paguajë shumat nën lartësitë si në dispozitiv të aktgjykimit, duke gjetur se përgjegjësia për dëmin e shkaktuar paditësve është i siguruari të paditurës, pasi që me fajin e tij është shkaktuar aksidenti i komunikacionit në të cilën ka humbur jetën A. G..

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore pjesërisht ka pranuar ankesën e të paditurit duke ndryshuar shumat e dëmit jo material për paditësit dhe duke i caktuar në emër të dëmit jo material shumat si në dispozitiv të aktgjykimit .

Duke u nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës së ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar. Por sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi gjendjen e vërtetuar faktike gabimisht janë aplikuar dispozitat e nenit 184 par. 1 të Ligjit mbi Detyrimet dhe nenit 223 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material paditësve I. dhe N., për dhimbje shpirtërore për humbjen e djalit A. ka gjykuar shumat secilit nga 9,000.00€ ,dhe

paditësve I., K., M., M. B. dhe S. G. , për vdekjen e vëllait, ka gjykuar nga 5000,00 €, në këtë pjesë aktgjykimi i goditur u deshtë të ndryshohet dhe të vendoset si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata Supreme vlerëson se shumata e gjykuara nga kjo Gjykatë në emër të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore për vdekjen e djalit dhe vëllait të paditësve I1., N., I2, K., M1., M2 , paraqet si satisfaksion të plotë, duke marrë parasysh shkallën e së mirë dhe qëllimit që shërben ky shpërblim, në kuptim të nenit 201 par. 1 të LMD-së, prandaj kjo Gjykatë pjesërisht ka pranuar revizionin e të paditurës duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së dytë sa i përket dëmit jo material në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e djalit dhe të vëllait të paditësve ,duke caktuar shumata paditësve I. dhe N. G. nga 9,000.00 , ndërsa paditësve M1., M2 B. dhe S. G., nga 5,000.00 € për secilin veç e veç . Prandaj, duke pasur parasysh kriteret e parapara me dispozitën e lartcekur shumata e gjykata si nën pikën I. të dispozitivit përkitazi me llojet e sipër cekura të dëmit jo material, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë reale në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore.

Pretendimet e revizionit se gjykata e instancës së ulët nuk kanë marrë parasysh lartësinë e kamatës ligjore prej 12% sikur se është përcaktuar me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia si ligj i veçantë duke filluar nga paraqitja e kërkesës për shpërblimin e dëmit të paditura deri të pagesa definitive , nuk qëndrojnë për faktin se kamata ligjore e pretenduar prej 12% sipas nenit 26 të Ligjit të Detyrueshëm nga Auto-Përgjegjësia ju referohet vetëm rasteve kur siguruesi brenda afatit të përcaktuar ligjor nuk ofron ofertën e saj për kompensimin e dëmit, e në rastin konkret e paditura KS “S.” ka ofruar ofertën brenda afatit ligjor, me dt. 19.10.2012 në shumë të përgjithshme prej 11.214,00€. Prandaj paditësve i takon kamatëvonesa në lartës prej 8% në bazë të nenit 382,2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 04/L-077) Thëniet tjera në revizion nga kjo gjykatë nuk janë vlerësuar pasi nuk janë me ndikim në vendosje sipas revizionit .

Lidhur me shpenzimet procedurale ,me qenë se lëndë në një pjesë sa i përket rentës së kapitalizuar është prishur për shpenzimet definitive do të vendos gjykata pas vendosjes lidhur me rentën.

Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe me zbatimin e nenit 224 par. 1 dhe 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.23/2019 datë 07.02.2019

Kryetar i kolegjit,

Erdogan Haxhibeqiri